

**Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina**



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagradi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vodosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Domid" Sh.P.K. të datës 27.11.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 22.11.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Rekonstruimi i rrugës Rexhep Luci dhe Qamil Hoxha" me nr. të prokurimit 616-23-10571-5-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** si pjesërisht e bazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Domid" Sh.P.K. e datës 27.11.2023 kundër kundër njoftimit mbi vendimin e datës 22.11.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Rekonstruimi i rrugës Rexhep Luci dhe Qamil Hoxha" me nr. të prokurimit 616-23-10571-5-1-1.
- II. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "Domid" Sh.P.K. se njoftimi mbi vendimin i dt. 22.11.2023 i autoritetit kontraktues për këtë aktivitet të prokurimit tanimë është anuluar për shkak të vendimit të zyrtarit përgjegjës të prokurimit lidhur me një kërkesë tjetër për rishqyrtim nga një tjetër parashtrues, ndërsa aktiviteti i prokurimit me të dhënat si në pikën I të vendimit tanimë është kthyer në rivlerësim.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "Domid" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Domid" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 27.11.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 22.11.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Rekonstruimi i rrugës Rexhep Luci dhe Qamil Hoxha" me nr. të prokurimit 616-23-10571-5-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in merito*) të kërkesës.

Faqe 1 nga 11

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000

Tel.: 038-200-40-111

Email: visar.shehu@rks-gov.net

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

- **Pretendimi i parë (I)** – “Sipas arsyetimit të parë të vendimit të kundërshtuar, tenderi/oferta jonë është diskualifikuar si e papërgjegjshme duke ju referuar arsyetimit se nuk kemi dorëzuar Planin Dinamik: Krysesisht pika Nr 15. Mirëpo, arsyetimi i AK-së nuk qëndron dhe respektivisht është i pabazuar në relacion me gjendjen faktike dhe bazën ligjore... Pretendimi nga ana AK-së se plani dinamik është i prezantuar mirëpo nuk është bashkangjitur fare, ky pretendim është i pabazë dhe se në shum raste gjatë dorëzimit të ofertave sistemi i e-prokurimit mund të ketë probleme teknike që realisht mund ta ngarkojnë dokumentacioni , dhe dokumentacioni të figurojë si i ngarkuar, mirëpo gjatë ngarkimit mund të ketë pasur gabim teknik, më poshtë do të tregojmë një argument nga një autoritet kontraktues tjetër ku AK ka kërkuar sqarim shtesë, për shkakë të gabimeve teknike në plateformen e e-prokurimit, në mënyrë që kërkesa për sqarim shtesë të jetë konfidenciale ne vetem do prezantojm se si është kërkuar sqarimi shtesë e qe kjo kërkësë më pasë mund të verifikohet edhe nga ana juaj pas ri-vlerësimit pasi që dokumenti është dokument zyrtar i postuar në platformën e e-prokurimit. Andaj ne mendojmë se AK- ka mund të kërkojë një sqarim shtesë në mënyrë që ekzaminimi dhe vlerësimi të jetë konform rregulloreve, pasi që Plani Dinamik është një plan i cili punohet nga një Inxhinier apo ndonjë menaxher i kompanisë dhe se është i letë për të punuar dhe vepruar në të, pasi që është ne EXCEL dhe mund të menaxhohet letë, pra nuk ka pasur arsyet qe ne grapi i konzorciumit OE i përmendur me lartë të mos e dorëzojmë këtë planë dinamik, pasi që kemi plotësuar të gjitha kërkësat e sipas Dosjes së tenderit mbi projektin në fjalë, në qoft se ne grapi i OE do të mos prezantonim dhe mos ta ngarkonim fare piken 6 sipas kërkësë se DT-së, atehere do të ishte me e logjikshme dhe me e pranuar edhe nga ana jonë, andaj kërkojmë nga ju që ta ri-vlersoni këtë pikë”.
- **Pretendimi i dytë (II)** - “grupi i operatorëve valdrini sh.p.k., ibrahim kurrumeli b.i. dhe ld construction sh.p.k., nuk ka dorëzuar stafin profesional sipas kërkësës në ftd , kërkësat mbi mundësitet teknike dhe profesionale 9.1 &9.2”.
- **Pretendimi i tretë (III)** - “OE i sukseshem ka paraqitur një kontratë mbi dhënie marrjen me qira e lidhur në mes të “Valdrini” sh.p.k dhe “B-Corp” sh.p.k me datën 24.10.2023 mbi projektin në fjalë për makinerin Kamion vetëshkarkues me kapacitet min 10m³, mirëpo marrëveshja apo kontrata në mes të këtyre 2 (dy) OE është e pavlefshme duke u bazuar dhe argumentuar se, kërkësë nga AK- ka qenë që sipas kërkese nr 3 dhe dëshmisë së kërkuar ku AK-kërkon që OE duhet të Marrëveshja duhet te jete ne emër te këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga të dyja palët, e ku sipas kontratës së prezantuar edhe e noterizuar me daten 25.10.2023 e që është dorëzuar nga të 2(dy) palët, po në atë kontratë nuk është shënuar validiteti i marrjes me qira të kontratës pra nuk ka paraqitur afat kohor sipas të vetë kërkësë të AK-së, e që i bie që OE nuk ka plotësuar saktë marrëveshjen dhe se validiteti i kësaj kontrate ka mundur të jetë vetem 1(një)ditorë, pra nga momenti kur nuk është paraqitur saktë data dhe kohëzgjatja, OE i shpallur i sukseshem nga AK, po argumentohet se ka dështuar që të mos plotësoj kërkësen Nr 3: andaj, pas largimit dhe mos vlefshmërisë të kësaj kontrate e qe duhet te bie posht që është në kundërshtim me kërkësen e AK-së, atehere kërkesa Nr 3 nuk plotësohet”.

- Pretendimi i katërt (IV)** - "Duke specifikuar natyren e punës dhe gjithmonë duke ju referuar specifikimeve të Aneksit dhe paramases, një kërkesë nga AK për këtë projekt ishte poashtu që OE duhet të ketë Një (1) Cilindra për ngjeshje të nën bazës, duke verifikuar makinerit e paraqitura nga OE; fitues ashtu e prezantuar edhe sipas Aneksi 8 OE ka dështuar të paraqes një makineri të tillë, pasi që OE fitues ka paraqitur një cilinder për ngjeshjen e nën bazës por cilindri i paraqitur nga OE fitues është cilinder me gjemba e që duke specifikuar punën ashtu sipas natyrës së projektit dhe paramasës cilindri i paraqitur nga ana e OE fitues nuk është i njejtë si cilindri për ngjeshjen e nënbazës pasi që cilindri me gjemba në natyren e keti projekti nuk kryen asnjë funksion, dhe se funksioni i cilindrit me gjemba është të bëjë ngjeshjen e dheut, në qoftë se ne vendosim cilindri për ngjeshjen e nënbazës pas shtrimit të zhavorit 0,150,0,61, dhe 0,30mm ashtu te specifikuar nga paramasa e keti projekti atehere ky cilinder do ta prish në totalë bazën, andaj OE është dashur të prezantoj cilinder pa gjemba që i përshtatet keti projekti dhe i përshtatet kërkesës së AK-së, andaj duke argumentuar më lartë i bie qe OE fitues ka dështuar të plotësoj kërkesen Nr: 3 duke mos prezantuar cilindrin specifikim sipas kërkesës".
- Pretendimi i pestë (V)** - "Sipas kërkesë të AK-së kryesisht pikës Nr 13.1 ku OE duhet të ofroj Vlera e sigurisë së tenderit 33 000 Vlefshmëria e sigurisë së tenderit ne ditë 120 Sigurimi i tenderit duhet te dorëzohet i skanuar se bashku me oferte, ndërsa forma origjinale e sigurimit te tenderit do të kërkohet të dorëzohet nga një tenderues të cilin autoriteti kontraktues ka për qëllim qe ta shpërbuje me kontratë. Mos dorëzimi i formës origjinale te sigurimit te tenderit shpije ne zbatimin e nenit 99.2 te LPP-se, duke parë në folderin e dorëzuar nga OE fitues tek folderi i sigurimit, e qe tek ky folder OE fitues ka prezantuar vetem deklaratën e sigurimit dhe se nuk ka prezantuar polisen e sigurimit e ku sipas kerkese se AK-së OE gjithmonë duhet të paraqet edhe polisen e sigurimit në menyrë që kërkesa të jetë e plotësuar, e që poashtu ka paraqitur sigurimin vetem në individual dhe jo si konzorcium, e ku sipas marreveshjes se konzorciumit, OE duhet qe edhe pjestaret te tjere te jene ne polisen dhe deklarten e sigurimit, se ne rast se OE lider deshton te krye funksionin e punës, ti konfiskohet sigurimi edhe OE te tjere, andaj mos deklarimi dhe mos prezantimi i polises se sigurimit OE del qe nuk e ka përbushur kerkesen kryesore per kete tender".

Lidhur me pretendimin e parë (I) të parashtruesit, ky pretendim i referohet kërkesës në dosjen e tenderit të formuluar si në vijim:

6.Planin dinamik profesional i punëve me Metodën e Gantogramit	6.Planin dinamik duhet të jetë i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik
---	---

Nga analizimi i mënyrës se si është formuluar pretendimi i parë ankimore mund të konstatohet se as për vet parashtruesin nuk është kontestues fakti që nuk është dorëzuar plani dinamik. Megjithatë i njëjti pretendon se ky dokument është dashur të dorëzohet pas mbylljes së afatit për dorëzimin e ofertave ose të kërkohet përmes sqarimeve shtesë nga Autoriteti Kontraktues. Në rastin konkret nuk mund të kërkohen sqarime shtesë për një dokument që nuk është dorëzuar fare sepse kjo do të përbënte ndryshim material të ofertës që është në kundërshtim me nenin 72 të LPP. Në anën anën tjetër Plani Dinamik është një nga dokumentet më të rëndësishme që duhet të dorëzohet së bashku me ofertën pasi që në rast se tenderuesi në fjalë shpallet fitues, atëherë ai ka për detyrim ligjor që ti përbahet planit të tij dinamik në përputhje me kontratën e nënshkruar. Vlen të shtohet po ashtu se kriteri i dhënies për këtë aktivitet të prokurimit ka qenë tenderi ekonomikisht më i favorshëm pika e dytë e vlerësimit ka qenë pikërisht "afati më i shkurtër i

implementimit deri në max. 120 ditë” dhe si i tillë ky kriter është vlerësuar deri me 20 pikë respektivisht deri në 20%. Duke qenë se afati i implementimit parimi shëtë i ndërlidhur me planin dinamik, atëherë mungesa e planit dinamik nënkupton që tenderuesi përkatës (në këtë rast parashtruesi) automatikisht duhet të eliminohet si tenderues i papërgjegjshëm nga ky aktivitet i prokurimit. Prandaj pretendimi ankimore në mënyrën sikurse është formuluar është kundërthënës dhe i pabazuar në tërsi.

Lidhur me pretendimin e dytë (II) të parashtruesit, fillimisht duhet sqaruar se kërkesa e dosjes së tenderit të cilës i referohet ky pretendim është formuluar si në vijim:

<ul style="list-style-type: none"> - Një (1) menaxher i projektit - inxhinier i ndërtimitarisë master në drejtimin konstruktive, me së paku 7 vite përvojë pune profesionale pas diplomimit - Një (1) Inxhinier i Ndërtimitarisë – Drejtimi Konstruktivë apo fushës së ndërtimit të rrugëve 5 vite pervoje pune pas diplomimit - Një (1) Inxhinier i Ndërtimitarisë – Drejtimi i Hidroteknikës 5 vite pervoje pune pas diplomimit. - Një (1) Inxhinier i Elektroteknikës – Energetikës apo bachelor 5 vite pervoje pune pas diplomimit. - Një (1) Inxhinier i Ndërtimitarisë – Gjeodezisë 5 vite pervoje pune pas diplomimit. - Dy (2) Teknik – Drejtimi i Ndërtimitarisë (bachelor) 3 vite pervoje pune pas diplomimit 	<ul style="list-style-type: none"> - Diplomat universitarë ne baze te kerkesave te kerkura – Kopjet e Noterizuar per secilen diplome te kerkuar; • CV-në e nënshkruar nga kandidati; • Përvojë pune profesionale duhet të dëshmohet përmes kontratës (Kontratave me punëdhënësit) së punës apo vertetimeve te ATK-se.
---	--

Parashtruesi i kërkesës për rishqyrtim pretendon se tenderuesi i rekomanduar nuk i ka dorëzuar të gjitha dokumentet e nevojshme për stafin profesional sikurse është përcaktuar me kërkesën sikurse në tabelën më sipër. Prandaj është administruar si provë dosja e dokumenteve me të cilën ka ofertuar tenderuesi i rekomanduar. Me këtë rast është gjetur se tenderuesi i rekomanduar ka dorëzuar listën e stafit si në vijim:

LISTA E STAFIT NDIHMEQE DO TE JENE TE ANGAZHUAR NE REALIZIMIN E PUNEVE				
Nr.	Emri dhe Mbiemri	Profesioni	Eksperiencia (vite)	Pozicioni ne Kompani
1	Qendrim Kurumeli	Bachelor Infrastrukturë rrugore	8	Teknik i ndërtimitarisë(Bachelor)
2	Sadik Pilani	Inxhinier I Ndërtimitarisë-Hidro	15	Inxhinier i Hidros
3	Luan Abazi	Inxhinier Gjeodezie	12	Gjeodet
4	Faruk Kryeziu	Inxhinier I Ndërtimitarisë-Konstruktiv	16	Inxhinier Konstruktiv
5	Hivzi Kabashi	Inxhinier I Ndërtimitarisë-Konstruktiv	7	Menaxher Projekti
6	Mergim Gjoka	Bachelor I Energetikës	6	Bachelor I Energetikës
7	Nderim Krasniqi	Shkollen e Mesme	5	Shofer
8	Majlinda Kurumeli	Ekonomiste	7	ZP
9	Valdrin Kurumeli	Shkollen e Mesme	2	Shofer
10	Rino Krasniqi	Shkollen e Mesme	2	Punëtor fizik
11	Krenar Seferaj	Shkollen e Mesme	8	Shofer
12	Meriton Selmani	Shkollen e Mesme	10	Manipulues I makinerise

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Profesioni	Eksperiencia (vite)	Pozicioni ne Kompani
1	Achërie Kurumeli	Bachelor Infrastrukturë rrugore	7	Teknik e Ndërtimitarisë (Bachelor)
2	Bekim Krasniqi	Shkollen e mesme	20	Shofer
3	Bashkim Krasniqi	Shkollen e mesme	18	Shofer
4	Ondres Zogu	Kontabiliste	13	Kontabiliste
5	Mynyre Kurumeli	Shkollen e mesme	19	Asistente

Drenas,2023


DRENAS,2023

Faqe 4 nga 11

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000

Tel.: 038-200-40-111


Email: visar.shehu@rks-gov.net

Lidhur me pikën e parë të kërkesës "Një (1) menaxher i projektit - inxhinier i ndertimtarisë në drejtimin konstruktive, me së paku 7 vite përvoje pune profesionale pas diplomimit", tenderuesi i rekomanduar ka përcaktuar z. Hivzi Kabashi. Për të njëjtin janë dorëzuar dokumentet si në vijim:

1. Diplomën me nr. 1264 të datës 09.03.2022 të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtinë" Fakulteti i Ndërtimtarisë - Drejtimi Konstruktiv, të noterizuar sipas vërtetimit LRP nr. 262/2023 të datës 17.01.2023;
2. CV të nënshkruar;
3. Kontratën e punës të lidhur me punëdhënësin "Construction Group" Sh.P.K. të lidhur me datë 01.12.2010 sipas të cilës punëmarrësi themelon marrëdhënien e punës në kohë të pacaktuar duke filluar nga data 04.01.2016 (shih nenin të kontratës).

Lidhur me personin në fjalë (z. Hivzi Kabashi) janë dorëzuar edhe disa dokumente shtesë (referencia, deklarata, etj) të cilat nuk janë kërkuar nga autoriteti kontraktues përmes dosjes së tenderit dhe si të tilla nuk mund të manifestojnë asnjë ndikim mbi vlerësimin përfundimtar të ofertës përkatëse.

Bazuar në diplomën e dorëzuar për z. Hivzi Kabashi, është gjetur se i njëjti ka diplomuar dhe ka marrë titullin "Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë" me datë 09.03.2022. Ky fakt është provuar përmes diplomës së dorëzuar ku evidentohet data e diplomimit si vijon:



Përndryshe, fakti që z. Hivzi Kabashi ka diplomuar me datë 09.03.2023 është konfirmuar edhe përmes vërtetimit të noterizuar të diplomës të dorëzuar me ofertë si në vijim:

**VËRTETIM I KOPJES SË ORIGJINALIT**

Astrit S. Bibaj, noter në Prishtinë, Rruga "Garibaldi" nr. 15/5, vërteton se:
 Kopja e dokumentit që i primë tekstit, e verifikuar nga noteri, në të gjitha pikëpamjet është konform kopje identike me originalin e sjellë nga pala:
z. HIVZI KABASHI, i lindur me datë: 22/08/1981, (njëzet e dy gusht një mijë e nënëqind e tetëdhjetë e një) në: Istog, bartës i dokumentit të identifikimit të lëshuar nga MPB-RKS, me nr. personal: 1005785347, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Dokumenti: Diplomë, me nr. 1264, e datës: 9 mars 2022, lëshuar nga: Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" – Fakulteti i Ndërtimitarise, e sjell nga pala është prezantuar si original dhe noteri, nuk merr përgjegjësi për përmbytjen e kësij dokumenti dhe informata që ka dokumenti dhe pala garanton për vërtetësinë e tyre.

Veprimi i noterizimit u bë në Prishtinë, në zyrën e noterit, me datë: shtatëmbëdhjetë janar dy mijë njëzet e tre (17.01.2023), h 09:16.

Dokumenti i sjellë nga pala është fotokopjuar në zyrën e noterit, ka 1 faqe, është zvogëluar nga formati A3 në formatin A4, është vërtetuar në 1 kopje-ekzemplar, dhe është paguar në shumë prej 1 € + 10 cent për faqe + TVSH në bazë të nentit 29, dhe neni 42 pikë nr. 1 konform U.A. për Tarifat Notariale nr. 05/2022.



Nga dëshmitë më sipër në mënyrë të pakontestueshme është provuar se data e diplomimit të z. Hivzi Kabashi është 22.03.2022. Në anën tjetër nuk është aspak kontestues fakti që sipas dosjes së tenderit është kërkuar që menaxheri i projektit që është z. Hivzi Kabashi në rastin konkret të ketë së paku shtatë (7) vite përvojë të punës profesional pas datës së diplomimit. Nga ky kënd i vështrimit është e pamundur që të dëshmohet kjo përvojë pasi që ende nuk kanë kaluar shtatë (7) vite kalendarike që nga data e diplomimit të personit në fjalë. Me fjalë të tjera, menaxheri i projektit i cili duhet të jetë edhe inxhinier i ndërtimit – drejtimi konstruktiv nuk e përbushë kërkësën për përvojë të punës prej shtatë (7) viteve pas datës së diplomimit. Me këtë rast duhet cekur faktin që në diplomën e z. Hivzi Kabashi potencohet që i njëjtë ka regjistruar studimet në vitin 2001 ndërsa ka përfunduar provimet në vitin 2006, mirëpo nuk ka arritur të diplomoj deri në vitin 2022. Periudha kur janë regjistruar dhe kur janë përfunduar provimet (2001 deri 2006) korespondojnë edhe me datat që janë evidentuar në CV të z. Hivzi Kabashi. Mirëpo duhet pasur parasysh që përmes dosjes së tenderit janë kërkuar shtatë (7) vite përvojë të punës profesional pas datës së diplomimit. Pra nuk është fare relevante nëse ndërmjet datës kur janë përfunduar provimet dhe datës së diplomimit ekziston një hapësirë e konsiderueshme kohore (si në rastin konkret). Për këtë aktivitet të prokurimit duke marrë parasysh dosjen e tenderit është relevante ekskluzivisht data e diplomimit.

Duhet shtuar se në ofertën e tenderuesit të rekomanuar lidhur me menaxherin e projektit (Hivzi Kabashi) janë dorëzuar edhe disa dokumente të cilat nuk janë kërkuar nga autoriteti kontraktues përmes dosjes së tenderit. Fjala është për disa referenca, vërtetime apo dokumente të ngjashme ku në disa raste thuhet se z. Hivi Kabashi është inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë edhe para vitit 2022. Ngjashëm edhe sa i përket

punonjësit tjetër z. Sadik Pllana janë dorëzuar disa dokumente sipas të cilat vërtetohet se i njëjti ka punuar njëkohësisht edhe në sektorin publik por edhe në sektorin privat. Pa paragjykim ndaj këtij fakti, duhet theksuar se komisioni për (ri)vlerësim është i detyruar që ndër të tjera edhe të ekzaminoj dokumentet me të cilat ofertojnë tenderuesit. Nëse me këtë rast gjejnë se ato dokumente mund të kenë përbajtje të rrejshme apo mashtruese, atëherë komisioni duhet të veproj sipas legjislacionit në fuqi.

Lidhur me pikën e dytë të kërkesës "Një (1) Inxhinier i Ndërtimtarisë – Drejtimi Konstruktivë apo fushës së ndërtimit të rrugëve 5 vite pervoje pune pas diplomimit", tenderuesi i rekomanuar ka përcaktuar z. Faruk Kryeziu. Për të janë dorëzuar dokumentet si vijon:

1. Diplomën me nr. 638 të datës 28.01.2008 të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtinë" Fakulteti i Ndërtimtarisë - Drejtimi Konstruktiv, të noterizuar sipas vërtetimit LRP nr. 11809/2023 të datës 06.10.2023;
2. CV të nënshkruar;
3. Një parakonratë të punës të lidhur me punëdhënësin "Valdrini" Sh.P.K. të lidhur me datë 26.10.2023.
4. Vërtetimet nga ATK të lëshuara për vitin 2018, 2019, 2020, 2021, 2022 dhe 2023.

Lidhur me personin në fjalë (z. Faruk Kryeziu) janë dorëzuar edhe disa dokumente shësë (referencia, deklarata, etj) të cilat nuk janë kërkuar nga autoriteti kontraktues përmes dosjes së tenderit dhe si të tilla nuk mund të manifestojnë asnje ndikim mbi vlerësimin përfundimtar të ofertës përkatëse.

Fillimi shi duhet sqaruar se sipas kësaj pike të kërkesës në fjalë të dosjes janë kërkuar pesë (5) vite përvojë të punës pas datës së diplomimit. Për të dëshmuar këtë fakt, përmes dosjes së tenderit janë kërkuar ose kontratat e punës me punëdhënësit në fjalë ose vërtetimet nga ATK përmes të cilave dëshmohet përvuja e kërkuar e punës prej pesë (5) viteve. Në rastin konkret nuk janë dorëzuar kontrata të punës të cilat do të mund të dëshmonin se personi në fjalë (z. Faruk Kryeziu) ka së paku pesë (5) vite përvojë të punës pas diplomimit. Sa i përket parakonratës së dorëzuar, duhet cekur se kjo konratë është lidhur me datë 26.10.2023 dhe nuk dëshmon asnjë ditë të përvojës së punës pas diplomimit pasi që manifeston vetëm një marrëveshje paraprake që të themelohet marrëdhënia e punës me kusht që të nënshkruhet kontrata për të cilën kanë aplikuar në këtë aktivitet të prokurimit. Përndryshe kjo konratë është nënshkruar në ditën kur është bërë edhe hapja e ofertave (26.10.2023) që nënkupton se ka gjasa që si e tillë të jetë edhe e papranueshme përderisa nuk vërtetohet se është lidhur dhe është nënshkruar para afatit të fundit për dorëzimin e ofertave (që ka qenë data 26.10.2023). Sidoqoftë kjo parakonratë nuk ka asnjë vlerë provuese në kuptim të kërkesës së përcaktuar me dosjen e tenderit pasi që nuk është kërkuar të dorëzohet nga autoriteti kontraktues dhe si e tillë nuk mund të ketë asnjë efekt juridik në vlerësimin e tenderëve. Sa i përket dëshmisë mbi pesë (5) vite të përvojës së punës pas diplomimit për z. Faruk Kryeziu, janë dorëzuar edhe disa vëretime nga ATK për vitet 2018-2023. Në fakt këto vëretime nuk janë dorëzuar përmes ofertës por janë dorëzuar vetëm pas sqarime shësë të datës 20.11.2023 të kërkuar nga autoriteti kontraktues. Mirëpo pas analizimit të këtyre vërettimeve është gjetur si vijon:

- Faruk Kryeziu nuk figuron fare në listën e punëtorëve në vërtetimin e ATK për vitin 2018 dhe për vitin 2019.
- I njëjtë është evidentuar si punonjës vetëm në vërtetimin e ATK të vitit 2020 ku përcaktohet se personi në fjalë (z. Faruk Kryeziu) gjatë vitit 2020 i ka vetëm tetë (8) muaj të përvojës së punës konkretisht nga muaji i pestë (5) deri te muaji i dymbëdhjetë (12).
- Tëtje në vitin 2021 personi në fjalë sipas vërtetimit të ATK figuron se gjatë vitit 2021 i ka vetëm njëmbëdhjetë (11) muaj të përvojës së punës konkretisht nga muaji i dytë (2) deri te muaji i dymbëdhjetë (12).
- Tëtje në vitin 2022 sipas vërtetimit të ATK është gjetur se z. Faruk Kryeziu i ka dymbëdhjetë (12) muaj të përvojës së punës respektivisht vitin e plotë.
- Ndërsa në vitin 2023 sipas vërtetimit të ATK është gjetur se z. Faruk Kryeziu i ka nëntë (9) muaj të përvojës së punës konkretisht nga muaji i parë (1) deri te muaji i nëntë (9).

Nga sa u tha më sipër përmes vërtetimeve të ATK (listës së pagave) të dorëzuara nga tenderuesi i rekomanduar është konstatuar se z. Faruk Kryeziu i ka vetëm dyzet (40) muaj përvojë të punës. Në anën tjetër përmes dosjes së tenderit janë kërkuar së paku pesë (5) vite apo gjashtëdhjetë (60) muaj të përvojës së punës pas diplomimit. Bazuar në dokumentet që janë dorëzuar nga tenderuesi i rekomanduar përmes ofertës por edhe në dokumentet shtesë të dorëzuara si sqarime me datë 20.11.2023, tenderuesi i rekomanduar për këtë pikë të kërkuesës në fjalë (inxhinier i ndërtimtarisë - drejtimi konstruktiv) nuk ka arritur të dëshmoj se z. Faruk Kryeziu i ka së paku pesë (5) vite të përvojës së punës pas diplomimit. Kjo pasi që nuk janë dorëzuar kontratat me punëdhënësit me të cilët është zhvilluar kjo marrëdhënie e punës sikurse është kërkuar me dosjen e tenderit. Në anën tjetër as përmes vërtetimeve nga ATK - listave të pagave nuk është vërtetuar se personi në fjalë e ka pëmbushur kërkësën e përvojës së punës prej pesë (5) viteve.

Lidhur me pikën e pestë të kërkuesës “*Një (1) Inxhinier i Ndërtimtarisë – Gjeodezisë 5 vite përvoje pune pas diplomimit*”, tenderuesi i rekomanduar ka përcaktuar z. Luan Abazi. Për të njëjtin janë dorëzuar dokumentet si në vijim:

1. Diplomën me titull “Master Profesional në Inxhinieri Gjeodezi” me nr. MP-34 të datës 18.02.2014 të Universitetit Politeknik të Tiranës Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit - Niveli Master në Republikën e Shqipërisë, të noterizuar sipas vërtetimit LRP nr. 3156/2023 të datës 06.10.2023 së bashku me vendimin për nostrifikim me nr. 612242 të MASHT/RKS të datës 14.04.2014 të noterizuar sipas vërtetimit LRP 2544/2019.
2. CV të nënshkruar;
3. Një parakontratë të punës të lidhur me punëdhënësin “Valdrini” Sh.P.K. të lidhur me datë 26.10.2023.
4. Vërtetimet nga ATK të lëshuara për vitin 2018, 2019, 2020, 2021, 2022 dhe 2023.

Fillimisht duhet sqaruar se sipas kësaj pike të kërkuesës në fjalë të dosjes janë kërkuar pesë (5) vite përvojë të punës pas datës së diplomimit. Për të dëshmuar këtë fakt, përmes dosjes së tenderit janë kërkuar ose kontratat e punës me punëdhënësit në fjalë ose vërtetimet nga ATK përmes të cilave dëshmohet përvoja e kërkuar e punës prej pesë (5)

viteve. Në rastin konkret nuk janë dorëzuar as kontrata të punës të cilat do të mund të dëshmonin se personi në fjalë (z. Luan Abazi) ka së paku pesë (5) vite përvojë të punës pas diplomimit dhe as vërtetimet nga ATK - Listat e pagave. Sa i përket parakontratës së dorëzuar, duhet cekur se kjo kontratë është lidhur me datë 26.10.2023 dhe nuk dëshmon asnjë ditë të përvojës së punës pas diplomimit pasi që manifeston vetëm një marrëveshje paraprake që të themelohet marrëdhënia e punës me kusht që të nënshkruhet kontrata për të cilën kanë aplikuar në këtë aktivitet të prokurimit. Përndryshe kjo kontratë është nënshkruar në ditën kur është bërë edhe hapja e ofertave (26.10.2023) që nënkupton se ka gjasa që si e tillë të jetë edhe e papranueshme përderisa nuk vërtetohet se është lidhur dhe është nënshkruar para afatit të fundit për dorëzimin e ofertave (që ka qenë data 26.10.2023). Sidoqoftë kjo parakontratë nuk ka asnjë vlerë provuese në kuptim të kërkesës së përcaktuar me dosjen e tenderit pasi që nuk është kërkuar të dorëzohet nga autoriteti kontraktues dhe si e tillë nuk mund të ketë asnjë efekt juridik në vlerësimin e tenderëve. Përderisa nuk janë dorëzuar as kontratat e punës dhe as vërtetimet përkatëse nga ATK, nuk është arritur që të dëshmohet përvoja e punës pas diplomimit për personin në fjalë. Vlen të thuhet po ashtu se as përmes ofertës mirëpo as përmes sqarimeve shtesë nuk është dorëzuar diploma bachelor (studimet themelore) për inxhinierin e gjeodezisë z. Luan Abazi. Në vend të kësaj është dorëzuar diploma e studimeve master megjithatë është dashur patjetër që të dorëzohet edhe diploma e studimeve bachelor pasi që e njëjtë është kërkuar edhe përmes dosjes së tenderit ku askund nuk përmendet diploma master.

Për këto arsyen tenderuesi i rekomanduar nuk e ka plotësuar këtë kërkesë të dosjes së tenderit. Rrjedhimisht do të duhej që oferta e tij të përcaktohej si ofertë e papërgjegjshme ndërsa tenderuesi në fjalë të eliminohej nga ky aktivitet i prokurimit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimi i parë (I) ankimore lidhur me stafin profesional përkatësisht kërkueshëm e dosjes së tenderit lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional **është pretendim i bazuar** në tërsësi.

Lidhur me pretendimin e tretë (III) të parashtruesit duhet cekur se për parashtruesin nuk është kontestuese se është lidhur marrëveshje për marrjen me qera të pajisjes në fjalë por kontestohet vetëm fakti se kjo marrëveshje në dispozitat e saj nuk e ka përcaktuar vlefshmërinë e marrëdhënieve kontraktuale mes palëve përkatëse. Me këtë rast duhet potencuar që përmes nenit 4 të marrëveshjes është saktësuar si në vijim:

<p>Neni 4 Paisja do të mirret me qera për ta përdorur në zbatimin e projektit Rekonstruimi i rrugës Rexhep Luci dhe Qamil Hoxha - RITENDEER , me nr. prokurimi: 616-23-10571-5-1-1 dhe nr. I brend: 616 23 113/I 511 Neni 5 Lartësia e shumës së qeradhiqës, do të caktohet me një marrëveshje tjeter.</p>

Përderisa është cituar aktiviteti i prokurimit për të cilin është marrë me qira pajisja, parimisht duhet të nënkuptohej se marrëveshja është e vlefshme deri sa të realizohet kontrata lidhur me aktivitetin e prokurimit për të cilin është ofertuar. Megjithatë është fakt se në marrëveshje nuk është saktësuar vlefshmëria e qira marrjes/dhënieve. Prandaj ky pretendim është pjesërisht i bazuar.

Faqe 9 nga 11

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000

Tel.: 038-200-40-111


Email: visar.shehu@rks-gov.net

Lidhur me pretendimin e katërt (IV) të parashtruesit, ky pretendim i referohet aneksit 8 të dosjes së tenderit ku kërkonhet të dëshmohet posedimi i pajisjeve sipas listës si vijon:

Aneksi 8 Lista e Pajisjeve

MAKINERIA	Sasia	Të dhënët për pajisjet
Katër (4) Kamion vetëshkarkues, kapacitet min,10 m ³		
Dy (1) Ekskavator		
Një (1) Dozer		
Një (1) Grejder		
Një (1) Cilindra për ngjeshje të nënbazës		

Në anën tjetër, nga oferta e tenderuesit të rekomanduar është konfirmuar se është dorëzuar dëshmia (fotografia) se cilindri me të cilin është ofertuar është cilindër me xhemba (sikurse pretendon edhe parashtruesi). Shih fotografinë si në vijim:



Faqe 10 nga 11

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000

Tel.: 038-200-40-111

Email: visar.shehu@rks-gov.net

Qëllimi pse është kërkuar kjo pajisje është për ngjeshje të nënbazës (kjo përcaktohet shprehimisht përmes aneksit 8 të dosjes së tenderit). Përderisa nuk është cekur nëse cilindri kërkohet të jetë me dhëmëza (xhemba) ose pa dhëmbëza (xhemba), atëherë ky cilindër si i tillë duhet të jetë i pranueshëm edhe për ngjeshjen e nënbazës për çfarë edhe është kërkuar përmes aneksit 8 të dosjes së tenderit. Pra **pretendimi është i pabazuar**.

Lidhur me pretendimin e pestë (V) të parashtruesit, nga administrimi i ofertës së tenderuesit të rekomanduar është gjetur se lideri i grupit ekonomik "Valdrini" Sh.P.K. e ka dorëzuar sigurinë e tenderit që është pjesë përbërëse e policës me nr. 118984 në vlerë prej 33,000.00 euro dhe e vlefshme për 120 nga data 26.10.2023 deri me datë 23.02.2024. Në këtë mënyrë është gjetur se **pretendimi ankimore është i pabazuar**.


Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur vetëm pretendimin e dytë ankimore dhe pjesërisht pretendimin e tretë ankimore ndërsa nuk ka paraqitur argumente të mjafueshme për të mbështetur pretendimin e parë, të katërt dhe të pestë ankimore. Në këtë mënyrë është gjetur se komisioni vlerësues nuk pra vepruar në përputhje me nenin 59 të LPP dhe 40 të RRPP. Për këto arsyë është miratuar si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP.

Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënët më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 06.12.2023



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.